



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 5608/2022
Data: 20.07.2022

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbal nga mbledhja e gjashtë -VI- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 30.06.2022 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: z.**Mehmet Ballazhi** (Kryetar i Komunës), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), **Kimete Kuka -Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Nexhmedin Daci** (Drejtoria për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrotje të Mjedisit), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergencë), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Informim), Përfaqësuesi i OSB-së. Kryesuesi i kuvendit pasi konstataoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstataoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Kuvendit të Komunës.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Korniza afatmesme buxhetore 2023-2025.
3. Propozim vendimi për themelimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së kuvendit të Komunës për vitin 2023.
4. Propozim vendimi për zgjatjen e afatit kohor për hartimin e Planit Zhvillimorë Komunal të Hanit të Elezit (PZHKS-s).
5. Propozim vendimi për zgjatjen e afatit kohor për hartimin e Hartës Zonale të Komunës (HZK).
6. Kërkesa e z.Latif Berisha për ndërrim destinimin e pronës.
7. Kërkesa e z.Sherif Lusnjani për ndërrim destinimin e pronës.
8. Raport nga tubimi për përgjedhjen e këshillave lokale të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane në territorin e komunës së Hanit të Elezit.
9. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pika e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

2. Korniza afatmesme buxhetore 2023-2025.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- projeksionet në kornizën fiskale komunale për vitet 2023-2025, janë të bazuara në përputhshmëri të plotë me kufijtë buxhetor me Qarkoren Buxhetore nr.2023/01 për Komunat dhe me parashikimet e miratuara me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve për vitet 2023-2025 të Qeverisë së Kosovës. Është mbajtur debati publik për kornizën afat mesme buxhetore dhe shumica e propozimeve të tyre janë në listën e projekteve kapitale. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë propozim apo sugjerim mund të parashtroni.

Zaim Bela thekson:- katër pozitat në arsim a janë të specifikuara se ku do të jenë. Projekti për rrugën Paldenicë –Ramuk nuk bënë me u ndarë për shkak se ka mbetur një aks rrugorë dhe është mirë që kur të realizohet ai projekt të bëhet komplet.

Lindita Ballazhi thekson:- në arsim janë katër pozita të reja të aprovuara të cilat janë të specifikuara dhe prej tyre dy janë për mësimdhënësit me nevoja të veçanta, një specialistë i ajtisë dhe një në rolin e këshillëdhënësit apo psikologut .

Mehmet Ballazhi thekson:- sa i përket rrugës të cilën e potencojoë z.Zaim Bela unë mendojë se duhet të bëhet projekt shtesë . Nuk është qëllimi që mos me bërë rrugën por është problem i mjeteve buxhetore për shkak se përqendrimin e kemi pasur për projektet që mund të kryhen por do të shikohen mundësit që edhe ajo pjesë me u kryer nëse është e shkurtë ajo pjesë e rrugës.

Ajnure Thaçi thekson:- faqe 23 është potencuar ndërtimi i trotuareve për këmbësorë në zonat urbane dhe rurale dhe kërkoj nga drejtoria për urbanizëm që në kuadër të këtij projekti të hynë edhe ndërtimi i trotuarit për këmbësorë në rrugën “Isen Suma”

Refet Kalisi thekson:- është një rritje shumë e madhe për të hyrat vetanake dhe është problem për me inkasuar. Është planifikuar renovimi i objektit të komunës por kërkoj sqarim se çka është menduar me u rregulluar. Ndërtimi i aneksit për këmbësore te “Ura e Seçishtës”, rregullimi i instalimit të elektrik në objektin e QKMF-së.

Hanumshahe Dibrani thekson:- ndërtimi i mbikalimit në zonat urbane janë paraparë 5000 € ku është paraparë . Janë paraparë 5000 € për rregullimin e shtratit të lumit Lepenc a janë të mjaftueshme këto mjete.

Resul Suma thekson:- sa i përket ndërtimeve të rrugëve të gjithë fshatrat ishin të përfshirë përvëç fshatit Dimcë që nuk është përfshirë dhe është mirë të përfshihet rregullimi i rrugicave me kupëza betoni. Kërkoj që edhe në fshatin Dimcë të përfshihet projekti për rregullimin e krojeve të fshatit.

Malik Berisha thekson:- është mirë që të ndahet AMF-ja prej pjesës tjetër për shkak se po bëhet dëmtimi i oborrit të AMF-së dhe do të ishte më mirë me ndarë veç AMF-në dhe veç pjesën e rregullimit të një këndi të lojërave

Lindita Ballazhi thekson:- të hyrat janë përcjell prej qarkores buxhetore e cila është dërguar prej Ministrisë dhe nuk i kemi planifikuar ne si komunë. Kjo shumë është e madhe për komunën tonë dhe ne do të tentojmë që këtë shumë me ulu dhe kjo kornizë afat mesme buxhetore është fillestare sepse do të kemi qarkoren e dyte dhe në shtator mund të ketë ndryshime.

Sherif Berisha thekson:- projekti për te ura e Seçishtës që është paraparë është e nevojshme edhe te Ura e Fezës me u bërë për shkak se më e rrezikshëm është ajo urë se sa ura e Seçishtës. Ne do t'i përcjellim me shkrim disa projekte të cilat ne mendojmë se janë të nevojshme për me u realizuar.

Nora Xhoni thekson:- është planifikuar riparimi i objekteve të trashëgimisë kulturore në fshatin Pustenik dhe pse nuk është planifikuar zhvillimi i turizmit rural, rregullimi i trafos dhe rregullimi i kanalizimit.

Hyriete Isufi thekson:- a është menduar për me ndërtuat ndonjë impiant për shkak se lumi është shumë i ndotur. Për këtë çështje a është bërë ndonjë bisedë me komunat e regionit për me ndërtuar ndonjë impiant të përbashkët.

Mehmet Ballazhi thekson:- mbikalimin te zonat urbane e kemi si planifikime dhe shuma prej 5000 € për shkak se duhet të përcaktohet si kod ekonomik sepse nëse nuk e kemi si kod nuk mundemi me zhvilluar si projekt apo me bërë kërkesë përmes donatorëve për me realizuar si projekt. Projekti i lumenj Lepenc është projekt ndërkombëtarë për shkak se ka një kosto të madhe por është marrëveshja ndërkombëtare që do të miratohet nga Qeveria e Kosovës pastaj në Parlament por e mira e krejt kësaj është se Banka Botërore e ka pranuar si projekt dhe kjo varet prej nivelit qendrorë për me realizuar. Projektin për te AMF-ja për me ndarë ndoshta do të ishte mirë me ndarë për shkak dëmtimeve që po bëhen por ne kemi planifikuar trajtimin e hapësirave të asaj pjesë por do ta diskutojmë këtë çështje. Aneksi i Urës Seçishtës është planifikuar për shkak të rrezikshmërisë për shkak se nuk kemi pasur mundësi për urë tjetër dhe zgjidhje më e mirë dhe më e sigurt për këmbësorë ka qenë një diçka e ndarë. Këtë projekt planifikojmë me realizuar përmes Ambasadës së Japonisë dhe po besoj që do të financohet. Sa i përket impianteve është pak problem për shkak se janë të kushtueshme. Komuna e Ferizajt, Kaçanikut dhe Shtërpca e kanë një projekt të përbashkët për impiant dhe ende nuk e kanë kryer dhe ne nuk jemi të përfshirë në këtë projekt. Sa i përket aneksit që u potencua për te "Ura e Fezës" është pak problem se nuk e kemi ndonjë studim të fizibilitetit për me parë se sa është i mundshëm realizimi i aneksit.

Ibadete Kalisi thekson:- te shkolla fillore në fshatin Seçisht duhet të rregullohet nxemja për sezonin dimërore .

Nexhmedin Daci thekson:- sa i përket renovimit të komunës bëhet fjalë për zyret në katin e parë për shkak se nuk kanë hibercukë dhe kundërmon erë e rëndë , pastaj ka me u rregulluar sistemi i ventilimit dhe nëse do të kemi mjete do të bëhen edhe renovimi i banjove . Rregullimi i instalimit të rrjetit në QKMF patjetër duhet të bëhet për shkak se tash edhe nxemja qendrore është bërë me rrymë . Nëse keni ndonjë propozim për rihapje të ndonjë rruge në fshatin Dimcë mund ta propozoni. Sa i përket trafosë është çështje e KEDS-it , ndërsa sa i përket kanalizimit jemi duke u munduar me punuar në atë drejtim. Sa i përket nxemjes së shkollës në fshatin Seçishtë do të shikohen mundësit për me rregulluar.

Refet Kalisi thekson:- është mirë që me bërë një trafo te pjesa jonë.

Mehmet Ballazhi thekson:- kam biseduar në aspekt miqësorë me disa persona atje dhe kam kërkuar që me bërë një projekt që mos me pasur probleme në të ardhmen.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 14 për 1 abstenim (z.Sherfi Berisha nga LVV).

3. Propozim vendimi për themelimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së kuvendit të Komunës për vitin 2023.

Kryesuesi thekson:- në bazë të praktikave nga vitet e kaluara në grupin punues për hartimin e planit të punës së kuvendit kanë qenë anëtarët e komitetit për politik e financa. Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR THEMELIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2023

4. Propozim vendimi për zgjatjen e afatit kohor për hartimin e Planit Zhvillimore Komunal të Hanit të Elezit (PZHKS).

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:- dihet që në vitin 2016 është marr vendim për hartimin e planit zhvillimore por për shkak të kovidit ende nuk është kryer dhe kërkohet që të vazhdohet afati për hartimin e këtij plani. Zgjatja e afatit nuk ka shpenzime shtesë për komunën por vetëm për kompletim të dokumentacionit.

Zaim Bela thekson:- sa parashihet afati i zgjatjes se tash pas kësaj pike kemi pikë për ndërrim destinim dhe nëse nuk është në zonën ndërtimore nuk i ipet leja për ndërtimin e shtëpive nëse nuk është e planifikuar me plan zhvillimore.

Refet Kalisi thekson:- është mirë që sa më i shkurt me qenë afati për shkak se është në favor të komunës.

Nexhmedin Daci thekson:- pjesa më e madhe është kryer dhe është një dokument tjetër që kërkohet vlerësimi strategjisë në mjeshtëri dhe komuna duhet ta angazhon një ekspertë për me kryer atë pjesë, pastaj përcillet përmiratim në Ministri të Planifikimit Hapësinorë .

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR ZGJATJEN E AFATIT KOHOR PËR HARTIMIN E PLANIT ZHVILLIMORE KOMUNAL TË HANIT TË ELEZIT

5. Propozim vendimi për zgjatjen e afatit kohor për hartimin e Hartës Zonale të Komunës (HZK).

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:- drafti ka përfunduar për hartën zonale të cilën e kemi kryer me Gizin Gjerman por nuk mundet harta zonale pa e miratuar planin zhvillimore për shkak se plani zhvillimore është dokument bazik.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR ZGJATJNE E AFATIT KOHOR PËR HARTIMIN E PLANIT ZHVILLIMORE KOMUNAL TË HANIT TË ELEZIT (PZHKS)

6. Kërkesa e z.Latif Berisha për ndërrim destinimin e pronës.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Abduram Bushi thekson:- përveç materialit të cilin e kam përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Zaim Bela thekson:- a jeni konsultuar me drejtorin e urbanizmit për pronën për të cilën kërkohet të bëhet ndërrim destinimi se a është në zonën ndërtimore . Nëse është në zonë ndërtimore jemi për që me ju bëre ndërrim destinimi.

Abduram Bushi thekson:- jemi konsultuar me drejtorinë e urbanizmit dhe është në zonë ndërtimore.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA KËRKESA E LATIF BERISHA PËR NDËRRIM DESTINIM TË PRONËS

7. Kërkesa e z.Sherif Lusnjani për ndërrim destinimin e pronës.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA KËRKESA E SHERIF LUSNJANI PËR NDËRRIM DESTINIM TË PRONËS

8. Raport nga tubimi për përgjedhjen e këshillave lokale të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane në territorin e komunës së Hanit të Elezit.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Natyra Kalisi thekson:- në bazë të rregullores për bashkëpunim me fshatrat dhe lagjet urbane të komunës së Hanit të Elezit komisioni i raporton kuvendit të komunës për rrjedhën e tubimit. E kemi pasur njoftimin për procesin e këshillave të fshatrave përmes së cilit kanë qenë të planifikuara data e mbajtjes së zgjedhjeve të këshillave të fshatrave. Komisioni i kuvendit të komunës i ka zhvilluar të gjitha procedurat për zgjedhjen e këshillave të fshatrave. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund ta parashtroni.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

9. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Zaim Bela thekson:- në mbledhje të komitetit për komunitete të cilën e patëm u kërkua që të ipet si rekomandim që të ju ndahet një zyre shoqatës së pensionistëve te shtëpia e kulturës “Imri Curri” . Te objekti i çerdhes së fëmijëve a keni ndonjë plan për me vendosur ndonjë klimë për shkak se është nxehë.

Ibadete Kalisi thekson:- a keni bërë ndonjë projekt për trotuarin prej te shitorja “Besa” deri te shkolla fillore “Ilaç Thaçi” për shkak se ajo pjesa e rrugës është pak e rrezikshme për nxënës dhe është mirë me vendosur mbrojtëse .

Resul Suma thekson:- në QKMF tetë punëtorëve u ka skaduar kontrata që ka qenë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe nuk kemi të drejtë me shtuar staf. Unë kam biseduar me organizatën “Islamik Relief” për me na ndihmuar. Kërkoj që në mënyrë institucionale me ju dërguar ftesë për takim për shkak se ata janë të gatshëm me na ndihmuar si komunë dhe është mirë me na ndihmuar në shëndetësi apo në bujqësi. Te shkolla e mesme “Dardania” afér 34 apo 35 nxënës e kanë përsëritur vitin a keni menduar me shtuar një klasë profesionale apo ndonjë drejtim tjetër.

Mehmet Ballazhi thekson:- ndërprerja e kontratave në QKMF nga Ministria e Shëndetësisë kjo ko ndodhur në tërë Kosovës. Si kryetarë komune e mirëpresë shoqatën “Islamik Relief”, kërkesë kam parashtruar dhe në takim kam qenë në muajin e Ramazanit dhe i kemi diskutuar çështjet të cilat u përmendën deh ata patën premtuar që do të vijën por ende nuk kanë ardhur.

Hisni Luri thekson:- momentalisht i kemi pesë zyre të lira dhe do t'i shikojmë mundësitë që t'i akomodojmë OJQ-të të cilat kanë punë për zyre por do të shikojmë mundësit në të ardhmen. Sa i përket klimës që u kërkua që me u vendosur te çerdhja me KFOR-in Polak i kemi tre projekte dhe njëri prej projekteve është enkas vetëm për çerdhen. Në shkollë të mesme janë 32 nxënës të cilët e kanë përsëritur vitin, ndërsa vitet e kaluara janë përsëritur 25 nxënës. Po kërkohet që të ngritet cilësia në arsim dhe për me ngrit duhet të merren masa dhe kjo masë ndoshta është e nivelit që duhet të kalon nëpër disa etapa më shumë për deri sa me ardhur këtu, mirëpo kjo është zgjidhje të cilën e kanë bërë vetë profesorët dhe nuk mundemi me ju përzierë në vlerësimin e tyre. Shkolla profesionale më herët ka qenë po për shkaqe të ndryshme është mbyllur dhe për me bërë ndonjë klasë profesionale duhet ta kemi numrin e nxënësve të kompletuar.

Nora Xhoni thekson:- në Lagje të Re te përroi që është ai bazenti në fund të pastrohet se kishte marr një pamje tmerruese. Sa i përket klimës për në çerdhe as në Kosovë por edhe nëpër çerdhet e vendeve të ndryshme ndërkombëtare nuk ka klimë për shkak se është e ndaluar ku ka fëmijë të vegjël.

Refet Kalisi thekson:- drejtoria për shërbime publike e ka shënuar një shkrim që do të pimë ujë të freskët në muajin qershor por është vështirë me u bërë drejtor sepse premtimeve të cilat i japidh janë marr vesh siç duhet për me kryer një projekt dalin probleme të tjera. Problemi është te trafoja për shkak se është montuar një trafo që nuk i përgjigjet kapacitetit të trafove të cilat janë në Han të Elezit sepse në Han të Elezit trafoja është me kapacitet gjashtë – dhjetë, ndërsa trafot në Kosovë janë njëzet-dhjetë dhe e kanë montuar trfonë e në momentin e kyçjes e kanë vërejtur që është gabim dhe është dashur me hequr e me bërë kërkesë tjetër në KEDS pra procedurat e trafos e kanë zgjatur afatin. Dje e kam pranuar imell nga z.Allan për vonesat që janë bërë dhe shprehë keqardhje për garancën të cilën e ka dhënë.

Mehmet Ballazhi thekson:- jemi duke i vazhduar projektet që janë në vazhdimësi dhe se si është krijuar komunikimi me qeverisjen e kaluar ata është dashur me dhënë përgjigje. Unë kam komunikim shumë të shpeshtë me CDI-në, me kompaninë Teuta dhe me Bifurkacionin. Në momentin që nuk janë marr vesh siç duhet për me kryer një projekt dalin probleme të tjera. Problemi është te trafoja për shkak se është montuar një trafo që nuk i përgjigjet kapacitetit të trafove të cilat janë në Han të Elezit sepse në Han të Elezit trafoja është me kapacitet gjashtë – dhjetë, ndërsa trafot në Kosovë janë njëzet-dhjetë dhe e kanë montuar trfonë e në momentin e kyçjes e kanë vërejtur që është gabim dhe është dashur me hequr e me bërë kërkesë tjetër në KEDS pra procedurat e trafos e kanë zgjatur afatin. Dje e kam pranuar imell nga z.Allan për vonesat që janë bërë dhe shprehë keqardhje për garancën të cilën e ka dhënë.

Arsim Dernjani thekson:- çështjen e kanalit që u potencua e kemi parasysh por kompania ka pasur angazhime. Prej Girit e kemi një donacion dhe i kam porositur 200 shporta por janë duke i zhvilluar procedurat e prokurimit.

Kryesuesi thekson:- pusi i cili është krijuar te përroi i Lagjes së Re duhet të rrethohet për shkak se është rezik për fëmijët.

Sherif Berisha thekson:- gjatë muajit majë dhe qershor ka pasur kërkesa prej qytetarëve për pastrimin e mbeturinave të forta, nëse ka pasur pastrime a janë faturuar dhe sa ka pasur inkasime. Shitësve ambulantë është mirë me ju bërë një zgjidhje.

Hanumshahe Dibrani thekson:- te Ura e Seçishtës të bëhet pastrimi.

Refet Kalisi thekson:- te çerdhja e jonë vetëm një muaj pushim e kanë dhe në gjitha komunat çerdhet pushimin e kanë një muaj e gjysmë, është mirë me shikuar këtë çështje. Klimat të cilat janë hequr te ambulanta është mirë me i vendosur te çerdhja.

Mehmet Ballazhi thekson:- e kemi projektin për trajtimin e hapësirave të oborrit të komunës që përfshihet edhe posta por nëse janë vendosur ato pengesa vetveti nënkuption që mos me hyjnë aty dhe në momentin që do të fillon trajtimi i hapësirave nuk kanë me mundur me hyjë në atë pjesë. Çështjen e pushimit në çerdhe do ta shikojmë. Klimat të cilat janë hekë i kemi sistemuar te objektet fshatrave apo lagjeve të cilat janë për pritje për shkak se kemi pas kërkesa.

Xhevahir Dernjani thekson:- duke pasur parasysh dhe duke i shfletuar gjitha projektet të cilat janë bërë nga drejtori të dha te fshati Paldenicë rruga e cila është prej te Lagja Ramukve deri te Kroj i Fshatit kam kërkuar edhe më herët por është bërë me zhavor por është mirë që të asfaltohet ajo rrugë dhe është mirë të bëhet lindhja e kësaj rruge me atë pjesën që shkon te stanet për shkak se ajo pjesë mund të shfrytëzohet edhe për qytetarët. Falënderojmë Kryetarin e Komunës dhe Kryesuesin e Kuvendit për pajiset me llaptop për asamblenë komunale.

Zaim Bela thekson:- kërkesë kemi nga pensionistë për me i dërguar në bajë në Elbasan.

Mehmet Ballazhi thekson:- për familjet dëshmorëve duhet ta ripërtërimë marrëveshjen me bajun e Kllokotit. Sa i përket subvencionimit të pensionistëve për një bajt të Elbasanit jam për me i subvencionuar por duhet t'i shikojmë mundësitë buxhetore.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen. Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:31

Procesmbajtësi

Ayni Bushi

